



Prishtinë, 26 qershor 2026

**Të nderuara Media,
Të nderuar Qytetarë,**

Ju kam ftuar në këtë konferencë për të prezantuar rezultatet e auditimeve të kryera, të parapara me Planin Vjetor të Auditimit për Sezonin 2025/2026, të cilat pasqyrojnë një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi menaxhimin e financave publike.

Siç, jeni në dijeni, Auditori i Përgjithshëm ka për obligim ligjor që deri me 30 Qershor të çdo viti të përfundoj dhe publikoj raportet e auditimeve të detyrueshme të rregullsisë së pasqyrave vjetore financiare të të gjitha organizatave buxhetore. Përveç, kësaj, në përputhje me planin auditues, kemi kryer edhe auditimet e ndërmarrjeve publike me rendësi materiale dhe në interes të publikut. Raportet e auditimit janë një instrument i rëndësishëm për rritjen e transparencës, forcimin e llogaridhënies dhe përmirësimin e qeverisjes në sektorin publik. Nëpërmjet tyre, synojmë të kontribuojmë në përdorimin më efikas, efektiv dhe të përgjegjshëm të burimeve publike, në interes të qytetarëve.

Para se të filloj të ju informoj për rezultatet audituese, dua të shfrytëzoj rastin të ju falënderoj juve mediave për mbulueshmërinë e lartë të rezultateve tona audituese përgjatë gjithë sezonit auditues, e në veçanti kohëve të fundit, kur ZKA është duke publikuar në vazhdimësi raportet. Kjo, veçanërisht mendoj se është shumë e rëndësishme për faktin se kemi mungesë të konstituimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili përmes rezultateve tona të auditimit mban llogaridhënës institucionet përgjegjëse për shpenzimin e parasë publike.

Sipas planit auditues të sipërpërmendur kemi planifikuar të kryejmë gjithsejtë 145 auditime, prej të cilave janë publikuar 102.

- ✓ Deri me 30 qershor përfundohen dhe publikohen, 88 auditimet e detyrueshme të rregullsisë dhe 12 të Ndërmarrjeve Publike, përderisa, auditimet e tjera të

- Pajtueshmërisë, Performancës, atyre të klasifikuara dhe auditimeve të projekteve të Bankës Botërore pritet të përfundohet sipas planit përgjatë vitit.
- ✓ Raporti Vjetor i Auditimit për Buxhetin e Kosovës pritet t'i dorëzohet Kuvendit të Kosovës jo më vonë se 31 gusht të vitit 2026.

Dëshiroj të vendos në vëmendjen tuaj se, në planin auditues i dorëzuar në Kuvend dhe i publikuar nuk kanë qenë të përfshira 9 temat e auditimit të pajtueshmërisë, për të cilat tashme ka filluar auditimi.

Temat e përzgjedhura janë:

1. Menaxhimi i detyrimeve buxhetore që rezultojnë në vendime gjyqësore dhe përmbartimore;
2. Eficienca e energjisë në ndërtesat publike- Komuna e Prishtinës;
3. Vlerësimi i monitorimit dhe zbatimit të skemës të granteve të MZHR në kuadër të programit për zhvillim rajonal të balancuar;
4. Menaxhimi dhe monitorimi i subvencioneve në fushën e sportit-Komuna e Prishtinës;
5. Furnizimi me produkte për personat paraplegjik dhe tetraplegjik-SHSHKUK;
6. Menaxhimi i pronave të dhënave me qera në Komunën e Lipjanit;
7. Menaxhimi i pronave të dhënave me qera në Komunën e Skenderajt;
8. Menaxhimi i pronave të dhënave me qera në Komunën e Glllogocit; dhe
9. Menaxhimi i pronave të dhënave me qera në Komunën e Gjakovës.

Të nderura Media,

Deri më tani, në këtë sezon audituese kemi publikuar 94 raporte të auditimit të rregullsisë (financiar dhe pajtueshmërisë), prej tyre: 14 raporte për Ministrinë, 37 raporte për Komuna, 31 raporte për IP (përfshirë Kuvendin e Kosovës, ZKM, ZP dhe ShSHKUK), Raporti për RTK-në, 9 raporte për Ndërmarrje Publike si dhe 2 auditime të veçanta: për pasqyra të veçanta të KEK-ut për nevojat e ZRRE-së dhe KPMM-së).

Sa i përket raporteve për auditimet e performancës, deri më tani kemi publikuar 4 raporte, ndërsa, sot pritet të publikohen edhe 3 raporte tjera të auditimit të performancës, përderisa një raport i performancës është dërguar tek institucionet kompetente.

Ndërsa, Raportet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Komunës së Vitisë, Trepçës, Fondit të Sigurimeve Shëndetësore dhe Fondit të Mirëbesimit do të publikohen jo më larg se me 30 Qershor.

Për 94 Raporte të publikuara të auditimeve financiare dhe pajtueshmërisë për PVF-të, deri më tani, janë dhënë 55 opinione të kualifikuara (9 Ministri, 33 komuna, 8 Institucione të pavarura dhe 5 NP), 4 opinione të kundërta (NP) dhe 35 opinione të pamodifikuara: (4 Komuna: MV, Junik, Ranillug dhe Shtërpca; 5 Ministri: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes, MPJD, MSH dhe MFPT; 24 Institucione të Pavarura dhe 2 auditime të veçanta).

Për 9 ndërmarrjet publike, kemi dhënë 4 opinione të kundërta; (KRU-Hidrodrini Sh.a, KRM-Uniteti Sh.a, KRM-Pastertia Sh.a, dhe Stacionit të Autobusëve Sh.a) dhe 5 opinione të kualifikuara (KOSTT-Sh.a, KEK, KRU-Prishtina Sh.a, NPH Iber Lepenci Sh.a dhe Termokos Sh.a).

Ndërsa për dy auditimet e veçanta të KEK-ut, kemi dhënë opinione të pamodifikuara. Dua të shpjegoj se, opinionet e auditimit janë kualifikuar për shkak se ZKA ka identifikuar se cilësia e raportimit financiar nuk ka qenë në përputhje me standardet, kërkesat ligjore dhe rregullative. Pasqyrat financiare kanë përmbajtur keçdeklarime materiale për sa i përket prezantimit të shpenzimeve, të hyrave, llogarive të arkëtueshme, pasurive, detyrimeve, etj.

Sa i përket konkluzioneve të auditimit për pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret janë dhënë: 31 konkluzione të pamodifikuara, 58 të modifikuara dhe 3 konkluzione të kundërta (KRM Pastertia Sh.A dhe Stacioni i Autobusave Sh.A dhe Komuna e Prishtinës).

Ndërsa për dy auditimet e veçanta të KEK-ut, kemi dhënë opinione të pamodifikuara.

Sa i përket pajtueshmërisë me kornizën ligjore, çështjet kryesore që kanë ndikuar në konkluzionin jo të mirë, si për Nivelin Qendror dhe lokal e poashtu edhe Ndërmarrje Publike, janë:

- ✓ Mos respektimi i rregullave për procedurat e prokurimit;
- ✓ Nënshkrimi i kontratave për projekte kapitale, në mungesë të mjeteve buxhetore;

- ✓ Vonesa në realizimin e projekteve;
- ✓ Procesi i subvencionimit është përcjellë me mangësi nga planifikimi deri te monitorimi dhe zbatimi i tyre;
- ✓ Kontraktimi i projekteve rrugore pa leje ndërtimore;
- ✓ Mos kryerja e procedurave nga ministritë për bartje të pronësisë tek komunitatet përkatëse;
- ✓ Vonesa në pagesën e faturave përtej afatit ligjor prej 30 ditësh;
- ✓ Pranimi i mallit pa përmbushje të plotë të specifikave teknike;
- ✓ Komunitatet nuk kanë arritur të realizojnë inspektimin e së paku 20% të pronave të paluajtshme;
- ✓ Angazhimi i punonjësve për pozitat e rregullta të punës, me kontrata për shërbime të veçanta si dhe mos zbatimi i procedurave të prokurimit për angazhime të tilla; dhe
- ✓ Menaxhim jo i duhur i pronave të dhëna me qira; etj.
- ✓ Angazhimi i shërbimeve të auditimit nga auditori privat, për kundër faktit se ndërmarrja ishte subjekt i auditimit nga ZKA;
- ✓ Mos përditësimi i kontratave të të punësuarve, bazuar në vendimet e Bordit, për rritjen e pagës dhe vlerën e saktë të shujtës;
- ✓ Mos përfundimi i pranimi teknik dhe të funksionalizoj pasuritë;
- ✓ Menaxhimi i kontratave nuk është administruar përmes platformës së prokurimit elektronik (E-prokurimi); dhe
- ✓ NP nuk kishin hartuar dhe azhurnuar rregulloret sipas kërkesave ligjore për afarizmin e ndërmarrjes.

Të nderuara Media,

Për shkak të interesit publik, ndjeshmërisë së infrastrukturës kritike, materialitetit të lartë financiar dhe mangësive të identifikuara, dua të flas më shumë për rezultatet e disa nga auditimet e kryera, si:

1. Auditimi i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Prishtinës;
2. Auditimi i Performancës “Mbrotjtja dhe Siguria e Digave”;
3. Efektiviteti i shërbimeve të ngrohjes qendrore në Termokos;
4. Efikasiteti dhe efektiviteti i administrimit të pronave nga Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP); dhe

5. Sistemi elektronik për menaxhimin e studentëve.

Raporti i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2025 për Komunën e Prishtinës ka rezultuar me 25 rekomandime, nga të cilat 14 janë rekomandime të përsëritura, 3 janë pjesërisht të zbatuara, tetë janë rekomandime të reja.

Auditimi i Komunës ka rezultuar me Opinion të kualifikuar si pasojë e mangësive materiale në PVF.

Çështjet që e kanë ndikuar opinionin janë:

- Në 52 raste, në vlerë totale prej 7,766,370€, shpenzimet ishin klasifikuar në kategori ekonomike jo adekuate, përfshirë pagesa nga vendime gjyqësore/përmbartimore dhe pagesa tjera të realizuara nga Komuna, duke ndikuar në paraqitjen e saktë të shpenzimeve në PVF.
- Detyrimet kontingjente në PVF ishin mbivlerësuar për 27,289,835€, si rezultat i prezantimit jo të saktë të lëndëve gjyqësore.
- Obligimet e papaguara ishin paraqitur dy herë në PVF, duke rezultuar në mbivlerësim të detyrimeve për shumën prej 164,851€.
- Llogaritë e arkëtueshme në PFV ishin mbivlerësuar për 680,021€.

Ndërsa sa i përket pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi, kemi dhënë konkluzion të kundërt që nënkupton se transaksionet, aktivitetet dhe proceset e komunës nuk ishin kryer në pajtueshmëri me kornizën ligjore.

Çështjet kryesore që kanë ndikuar në konkluzionin e pajtueshmërisë janë:

Dobësi në menaxhimin, monitorimin dhe shfrytëzimin e pronës komunale në kuadër të projektit “Modernizimi i arsimit përmes inovacionit dhe trashëgimisë”

Ky projekt dhe marrëveshja e lidhur për këtë projekt, të cilën e kemi raportuar edhe vitin e kaluar ishte në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe Ligjin e Buxhetit për vitin 2024 për shkak se Komuna kishte deleguar të gjitha përgjegjësitë për zhvillimin e procedurave të prokurimit tek UNDP, por edhe kishte transferuar në formë të parapagimit vlerën prej 5.2 milion euro tek UNDP.

Bazuar në projekt dokumentin, ishin paraparë katër outpute që lidhen me rehabilitimin dhe rindërtimin e ndërtesës së Gërmisë, rehabilitimin dhe rizhvillimin e ndërtesës së Tulltorës, reformën në mësim përmes të nxënit virtual, si dhe forcimin e kapaciteteve komunale për zbatimin e ndryshimeve strukturore afatshkurtra dhe afatgjata. Data e përfundimit të projektit ishte përcaktuar 31.08.2026.

Auditimi ka nxjerr ne pah se:

a) Komuna nuk kishte kërkuar dhe siguruar me kohë raporte financiare dhe raporte monitorimi lidhur me ecurinë dhe realizimin e projektit, përkundër vlerës së konsiderueshme të mjeteve të transferuara dhe mundësisë së përcaktuar në marrëveshje që UNDP-ja t'i ofrojë këto raporte me kërkesë të Komunës. Raportet nga UNDP-ja ishin siguruar vetëm gjatë vitit 2026 pas kërkesës së auditorit. Nga Komuna ishte siguruar vetëm një raport i kompletimit të punëve për renovimin e pjesërishëm të objektit Gërmia;

b) Për shkak se të gjitha fondet ishin transferuar tek UNDP, auditorët nuk kishin qasje të drejtpërdrejtë në dokumentacionin dhe shpenzimet e realizuara nga UNDP-ja për zbatimin e projektit, çka kufizoi mundësinë e verifikimit të shfrytëzimit të mjeteve dhe realizimit të aktiviteteve të projektit. Si rezultat, auditimi është mbështetur kryesisht në raportet dhe informacionet e siguruar nga Komuna.

c) Sipas raportit të UNDP-së, projekti kishte pësuar ndryshime në fushëveprim, aktivitete dhe rialokim të buxhetit, pasi kostot e rehabilitimit dhe funksionalizimit të kompleksit të Tulltorës kishin tejkaluar buxhetin në dispozicion. Fillimisht, projekti kishte paraparë rivitalizimin e plotë të ndërtesave D1, D2 dhe D3 për instalimin e sistemit “Deep Space 8K” dhe mini-fabrikës robotike për prodhim të tullave, me vlerë të vlerësuar të investimit prej rreth 7,000,000€, ndërsa buxheti total i projektit METIAH ishte rreth 5,000,000€.

Pas konsultimeve ndërmjet Komunës dhe UNDP-së gjatë vitit 2025, fushëveprimi i projektit ishte reduktuar në disa faza, duke kufizuar ndërhyrjet vetëm në ndërtesën D1 dhe duke zhvendosur sistemin “Deep Space 8K” nga Tulltorja në ish-objektin e Gërmisë. Sipas raportit të UNDP-së, instalimi i linjës robotike të prodhimit mund të fillojë vetëm pas finalizimit të shumicës së punimeve ndërtimore dhe në varësi të konfirmimit të financimit dhe aprovimeve përfundimtare. Përkundër këtyre ndryshimeve, Komuna nuk kishte siguruar analiza apo dokumentacion të

mjaftueshëm lidhur me ndikimin e tyre në arritjen e objektivave të projektit dhe nuk ishte evidentuar ndonjë aprovim formal për ndryshimin e fushëveprimit.

d) Në ish-objektin e Gërmisë ishte realizuar renovim i pjesërishtëm dhe ishte instaluar sistemi “Deep Space 8K”. Gjatë verifikimit fizik të realizuar më 08.05.2026 kemi vërejtur se kjo hapësirë menaxhohej nga UNDP dhe ishte dhënë në shfrytëzim një operatori privat, i cili inkasonte të hyra nga menaxhimi i hapësirës. Komuna nuk kishte mekanizma monitorimi dhe kontrolli lidhur me të hyrat e realizuara, si dhe nuk ishte përcaktuar ndonjë përfitim financiar për Komunën.

e) Sipas konfirmimit të Drejtorisë së Pronës, për këtë pronë nuk ishin zhvilluar procedura për dhënie në shfrytëzim dhe nuk kishte aprovim paraprak nga Kuvendi Komunal. Po ashtu, nga konfirmimet me personat e angazhuar në menaxhim është konfirmuar se operatori privat nuk kishte obligime financiare apo kontraktuale ndaj Komunës, por vetëm marrëdhënie me UNDP-në. Përkundër faktit se objekti është pronë komunale, nuk ishte evidentuar ndonjë vendim i Kuvendit Komunal apo procedurë ligjore për dhënien në shfrytëzim të kësaj prone.

Monitorimi dhe koordinimi ndërmjet Komunës dhe UNDP-së lidhur me zbatimin e projektit janë zhvilluar kryesisht përmes komunikimeve dhe takimeve koordinuese, mirëpo mungesa e dokumentimit me shkrim, analizave dhe raporteve të rregullta financiare dhe operative ka ndikuar që Komuna të mos ketë evidencë të plotë dhe të dokumentuar lidhur me progresin, ndryshimet në fushëveprim, rialokimin e aktiviteteve dhe buxhetit gjatë zbatimit të projektit. Po ashtu, moszbatimi i kërkesave ligjore për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale ka rezultuar me përdorimin e objektit pa aprovim nga Kuvendi Komunal dhe pa procedura të përcaktuara ligjore.

Çështje tjetër është nënshkrimi i kontratës me operatorin ekonomik të papërgjegjshëm

Tek kontrata për projektin “Ndërtimi i sheshit Xhorxh Bush”, në vlerë të kontraktuar prej 18,162,896€, gjatë procesit të vlerësimit të tenderit kemi vërejtur se në paramasën dhe parallogarinë e ofertës së operatorit ekonomik fitues kishte gabime në përlllogaritjen e nëntotaleve. Kjo kishte ndodhur pasi gjatë përlllogaritjes nuk ishin përfshirë:- pozicioni 11 “Punët e strukturës së Katedrales” në kuadër të Sheshit Katedralja 01, në vlerë prej 1,176,403€; dhe- pozicioni 11 “Punët e Fontanës” në kuadër të Sheshit të Koncerteve 05, në vlerë prej 103,056€. Si rezultat, vlera totale e ofertës e përlllogaritur nga operatori ekonomik kishte rezultuar 18,162,896€, ndërsa

pas përfshirjes së këtyre pozicioneve, të cilat ishin pjesë e paramasës dhe paralogarisë së tenderit, vlera totale rezulton 19,442,355€, apo 1,279,459€ më shumë. Diferenca e identifikuar përfaqëson rreth 7% të vlerës së ofertës dhe tejkalon pragun e lejuar prej +/- 2% të përcaktuar me rregullore.

Përkundër kësaj, komisioni i vlerësimit nuk kishte identifikuar dhe trajtuar gabimet aritmetike sipas kërkesave të rregullores, kishte rekomanduar operatorin ekonomik për shpërbllim të kontratës dhe kontrata ishte nënshkruar bazuar në vlerën e pakorrigjuar të ofertës.

Zbatim i kontratës nga operatorë ekonomik të paautorizuar

Nga dy pagesa në vlerë totale prej 261,269€ të kontratës “Ofrimi i shërbimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave – Lot 2”, një pjesë e shërbimeve ishte realizuar nga një operator ekonomik që nuk ishte pjesë e grupit ekonomik me të cilin ishte nënshkruar kontrata.

Kjo ishte evidentuar gjatë shqyrtimit të dokumentacionit mbështetës të pagesave, përkatësisht faturave të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A. (KMDK), ku paraqiteshin sasi të mbeturinave të deponuara dhe operatorët ekonomik që kishin bërë dorëzimin e tyre në deponi.

Aplikim i gabuar i peshimit të çmimeve dhe i pragut ±30% në kontratë

Në dy raste, për kontratat e nënshkruara në vitin 2025 për “Ofrimin e shërbimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave – Lot 1 dhe Lot 2”, Komuna kishte aplikuar kontratë publike kornizë me çmime për njësi. Për shkak të sasive indikative, vlerësimi i ofertave ishte bërë përmes peshimit të çmimeve, përkatësisht çmimeve të poentuara sipas peshës së secilit pozicion.

Megjithatë, në nenin 3 të kontratave janë përfshirë njëkohësisht vlerat totale indikative të kontratave prej 1,200,000€ për Lot 1 dhe 800,000€ për Lot 2, çmimet e peshuara prej 65.80€ për Lot 1 dhe 65.50€ për Lot 2, si dhe devijimi i lejuar prej ±30%.

Përfshirja e pragut ±30% në këto kontrata nuk ishte në përputhje me kërkesat e rregullores, pasi në kontratat me çmime për njësi, ku vlerësimi bëhet përmes çmimeve të poentuara, nuk lejohet aplikimi i këtij pragu.

Hyrja në obligime kontraktuale pa fonde të mjaftueshme

Komuna në tri raste kishte lidhur kontrata pa pasur fonde të mjaftueshme të parapara në Ligjin e Buxhetit:- Për projektin “Ndërtimi i sheshit Xhorxh Bush” me vlerë 18,162,896€, me afat të përfundimit të punimeve prej 240 ditë pune, sipas Ligjit të Buxhetit Komuna kishte të ndara mjete buxhetore për periudhën 2025–2027 në vlerë totale prej 1,550,000€, që nënkupton se kishte hyrë në obligime kontraktuale pa mbulesë buxhetore. Komuna kishte paraparë mjete në vlerë prej 4,500,000€ në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025–2027, mirëpo ato nuk ishin përfshirë në Ligjin e Buxhetit 2025 për shkak të mos aprovimit me kohë të buxhetit për vitin 2025.

Për projektin “Ndërtimi i krahut të rrugës Muharrem Fejza – Rruga Prekazi” me vlerë të kontraktuar prej 394,772€, Komuna nuk kishte mjete të ndara në Ligjin e Buxhetit. Komuna kishte paraparë mjete prej 1,500,000€ në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025–2027, mirëpo ato nuk ishin përfshirë në Ligjin e Buxhetit 2025 për shkak të mosaprovimit me kohë të buxhetit për vitin 2025.

- Për projektin “Furnizim me automjete për nevojat e QKMF-së dhe QMU” me vlerë prej 176,855€, sipas Ligjit të Buxhetit Komuna kishte të ndara mjete për vitin 2025 në vlerë prej 50,000€, ndërsa për periudhën 2025–2027 në vlerë totale prej 168,580€. Duke qenë se afati për dorëzim kishte qenë 90 ditë nga dhënia e urdhërblertes nga Autoriteti Kontraktues, Komuna kishte hyrë në obligime kontraktuale përtej mbulesës së planifikuar buxhetore sipas Ligjit të Buxhetit.

Si rezultat, Komuna kishte marrë obligime kontraktuale pa siguruar paraprakisht mbulesë të mjaftueshme buxhetore sipas kërkesave të Ligjit të Buxhetit.

Fillimi i procedurave të prokurimit dhe nënshkrimi i kontratave pa sigurimin paraprak të lejeve ndërtimore

Në projektin “Ndërtimi i Sheshit Xhorxh Bush”, me vlerë të kontratës prej 18,162,896€, e nënshkruar me 06.02.2025, përderisa pëlqimi nga Drejtoria e Urbanizmit për lejimin e zhvillimit të punimeve ndërtimore ishte lëshuar më 10.03.2025. Ky pëlqim kishte lejuar zhvillimin e punimeve në të gjithë hapësirën, përveç punimeve strukturore në Sheshin Qendror, të cilat do të mund të realizoheshin vetëm pas sigurimit të marrëveshjeve për parcelat me posedim individual, pëlqimit nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve përmes QRTK-së, pëlqimeve për mbrojtje nga zjarri, lejes mjedisore komunale, si dhe pëlqimeve nga institucionet relevante si KEDS, KRU, Telekom dhe Termokos.

Dobësi në menaxhimin e pagesave përmes vendimeve gjyqësore dhe vonesa në ekzekutimin e pagesave

Gjatë vitit 2025, vlera e pagesave të realizuara përmes vendimeve gjyqësore ishte shumë e lartë, duke arritur në 45,691,077€.

Gjatë testimit të pagesave të realizuara përmes vendimeve gjyqësore kemi identifikuar mangësi në klasifikimin, dokumentimin dhe verifikimin e tyre, si dhe vonesa në realizimin e pagesave përtej afatit ligjor prej 30 ditësh. Pagesat ishin realizuar nga kategori të ndryshme ekonomike, ndërsa në disa raste mungesa e urdhrave përmbartimorë nuk na ka mundësuar ndarjen e saktë ndërmjet vlerës bazë, kamatës dhe shpenzimeve përmbartimore.

Rastet e identifikuar janë si më poshtë:

- Nga kategoria e investimeve kapitale ishin realizuar nëntë pagesa në vlerë prej 4,496,994€, ndërsa shpenzimet e kamatës dhe përmbartimit për këto pagesa ishin 81,800€.

- ✓ Nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve ishin testuar 16 pagesa në vlerë prej 3,963,155€. Për pesë prej tyre, në vlerë prej 1,722,821€, janë siguruar dëshmi për shpenzimet e përmbartimit në vlerë prej 226,851€. Ndërsa, për 11 pagesa në vlerë prej 2,190,334€, nuk janë siguruar urdhrat përmbartimor, andaj nuk kemi mundur të përcaktojmë ndarjen ndërmjet vlerës bazë, kamatës dhe shpenzimeve përmbartimore.
- ✓ Po ashtu, për një pagesë të realizuar nga kategoria e subvencioneve për paga dhe mëditje, në vlerë prej 134,445€, nuk janë siguruar urdhrat përmbartimor, me qëllim të verifikimit dhe ndarjes së shpenzimeve.
- ✓ Në një rast tjetër, tek një vendim gjyqësor i paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në vlerë prej 147,143€ për paga jubilarë, kemi vërejtur se shuma prej 11,758€ kishte të bënte me dy punonjës për të cilët debitor nuk ishte Komuna e Prishtinës, por Ministria e Punëve të Brendshme. Megjithatë, pagesa ishte realizuar nga Komuna, pasi këta punonjës ishin përfshirë në listën e pagesës.

Gjithashtu, nga testimi i 22 pagesave tek investimet kapitale, në vlerë të përgjithshme prej 5,367,739€, si dhe 20 pagesave tek mallrat dhe shërbimet, në vlerë totale prej

2,797,791€, kemi vërejtur se faturat ishin paguar me vonesë, përtej afatit ligjor prej 30 ditësh. Vonesat në pagesë kanë qenë nga 9 deri në 131 ditë.

Kjo kishte ndodhur për shkak të numrit të madh të obligimeve të bartura ndër vite dhe mungesës së mjeteve të mjaftueshme financiare, të cilat janë ekzekutuar përmes vendimeve gjyqësore dhe procedurave përmbarimore.

Ndryshimet buxhetore për projekte kapitale pa aprovimin paraprak të Kuvendit Komunal

Në 46 pagesa të investimeve kapitale, në vlerë totale prej 10,192,709€, fondet janë marrë nga projekte të tjera të parapara me Ligjin e Buxhetit. Në 43 raste, në vlerë prej 9,979,842€, pagesat janë realizuar bazuar në kërkesat e drejtorëve të drejtorive përkatëse dhe me aprovim të Kryetarit, ndërsa në tri raste, në vlerë prej 212,867€, pagesat janë realizuar pa urdhëresë përkatëse. Si raste ku janë vërejtur më shumë mjete të marra nga projekte të tjera kapitale janë: pagesa e faturës në vlerë prej 500,000€ për projektin “Ndërtimi i sheshit Xhorxh Bush”, ku fondet janë marrë nga 15 projekte të ndryshme kapitale, si dhe pagesa në vlerë prej 173,365€ për projektin “Ndërtimi i shkollës në lagjen Kalabria”, ku mjetet janë marrë nga 8 projekte të ndryshme.

Ndryshimet në kushtet e kontratës pa aprovimet e duhura

Në katër kontrata për punë kemi identifikuar ndryshime në sasi të realizuara të disa pozicioneve, përmes rritjes apo zvogëlimit të sasive të kontraktuara, ndërsa në disa raste pozicionet e kontraktuara nuk ishin realizuar fare. Edhe pse këto ndryshime nuk kishin ndikuar në rritjen e vlerës totale të kontratës, ato ishin autorizuar vetëm nga menaxherët e kontratave, ndërkaq nuk ishte bërë amandamentimi i kontratave.

Ndryshimet janë identifikuar në kontratat si në vijim:

1. Në kontratën “Ndërtimi i tri mbikalimeve të përkohshme në Aktash, Lakrishtë dhe Arbëri”, në vlerë prej 428,216€, kishte rritje të sasive në disa pozicione në vlerë prej 11,491€, apo deri në 60% rritje krahasuar me sasi të kontraktuara.

2. Në kontratën “Ndërtimi i rrugëve në lagjen Kodra e Trimave”, në vlerë prej 598,764€, kishte rritje të sasive në pesë pozicione në vlerë prej 6,746€, apo deri në 80% rritje të sasive në pozicionet përkatëse. Njëkohësisht kishte edhe zvogëlim të sasive në pozicione të tjera.

3. Në kontratën “Ndërtimi i Bibliotekës në Kodër të Trimave”, në vlerë prej 418,000€, kishte rritje të sasive në disa pozicione në vlerë prej 13,212€, apo deri në 332% rritje krahasuar me sasitë e kontraktuara. Në anën tjetër, kishte edhe zvogëlim të sasive në pozicione të tjera; dhe

4. Në kontratën “Rikonstruimi i platos në lagjen Dardania, rruga Bill Klinton – tek Santea”, në vlerë prej 498,827€, kishte rritje të sasive në disa pozicione në vlerë prej 12,768€, apo deri në 235% rritje krahasuar me sasitë e kontraktuara.

Dobësi në zbatimin e projekteve kapitale gjatë verifikimit në terren qe lidhen me zbatimin e kontratave dhe mbikëqyrjen e punimeve, si në vijim:

1. Te projekti “Ndërtimi i sheshit Xhorxh Bush” dhe projekti “Ndërtimi i shkollës në lagjen Kalabria – Ritender”, gjatë verifikimit fizik të kryer ne terren kemi vërejtur se tek te dy këto projekte menaxheri i projektit i angazhuar në terren nuk ishte i njëjtë me personin e deklaruar në ofertën e operatorit ekonomik fitues. Për këto ndryshime nuk ishte siguruar kërkesë apo aprovim për zëvendësimin e stafit kyç.

3. Te projekti “Ndërtimi i rrugës A – pjesa e parë”, kontrata e nënshkruar më 24.03.2023 në vlerë prej 8,497,801€, gjatë verifikimit fizik kemi vërejtur se disa pozicione të paguara nuk ishin të vendosura në terren. Konkretisht, tek pagesa në vlerë prej 341,201€, për pozicionin 1.4.13 “Furnizimi, transporti dhe vendosja e gurëve natyral me dimensione 10/10/10 cm dhe 20/20/10 cm”, ishin paguar 2,835m² në vlerë prej 138,915€, ndërsa në terren mungonin afërsisht 1,200m². Po ashtu, për pozicionin 1.4.16 “Furnizimi, bartja, prerja dhe vendosja e skajoreve 7/20/50”, ishin paguar 5,435m në vlerë prej 76,090€, ndërsa në terren mungonin afërsisht 800m².

Subvencionimi i Organizatave Joqeveritare pa thirrje publike

Komuna kishte financuar Federatën e Futbollit të Kosovës, e cila ka statusin e organizatës joqeveritare, në vlerë prej 40,000€ për realizimin e projektit “Liga e shkollave të Prishtinës”. Për këtë qëllim, më 29.04.2025 Kryetari i Komunës kishte nënshkruar marrëveshje bashkëfinancimi me Federatën e Futbollit të Kosovës. Megjithatë, nga dokumentacioni i siguruar nuk rezulton se ishte paraqitur kërkesë nga përfituesi, se projekti ishte shqyrtuar dhe vlerësuar, si dhe se ishte zhvilluar procedurë e thirrjes publike për përzgjedhjen e projektit. Si rrjedhojë, financimi në vlerë prej 40,000€ ishte realizuar pa dëshmi për përmbushjen e procedurave të kërkuara për financimin publik të OJQ-ve.

Këto ishin vetëm disa nga çështjet e identifikuar ne auditimin e komunës se Prishtinës, raporti përmban edhe çështje të tjera të menaxhimit financiar dhe pajtueshmërisë të cilat mund t'i gjeni ne raportin i cili do te publikohet sot.

**Të nderuara media,
Të nderuar qytetarë,**

Përveç auditimeve financiare dhe auditimeve të pajtueshmërisë, Zyra Kombëtare e Auditimit deri më tani ka publikuar katër raporte të auditimit të performancës, ndërsa, sot pritet të publikohen edhe tri raporte të tjera të auditimit të performancës, si:

1. Efektiviteti i shërbimeve të ngrohjes qendrore në Termokos;
2. Efikasiteti dhe efektiviteti i administrimit të pronave nga Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP); dhe
3. Sistemi elektronik për menaxhimin e studentëve.

Ndërsa, Raporti i “Monitorimit, Mirëmbajtjes dhe Sigurisë se Digave” është dërguar tek palët përgjegjëse mirëpo ky nuk do te publikohet dhe ne vijim do t’ju njoftoj për arsyet e mos publikimit.

Për sa i përket auditimeve të performancës, njoftoheni se deri në fund të muajit gusht pritet të publikohen edhe nëntë raporte të tjera, ato janë:

1. Siguria e nxënësve në shkollat e mesme dhe të ulëta publike në Kosovë;
2. Mbështetja e nxënësve me nevoja të veçanta në arsimin fillor;
3. Fuqizimi i rolit të grave në pozitat udhëheqëse dhe marrje të vendimeve;
4. Furnizimi me barna për shëndetësinë primare dhe sëmundjet e rralla;
5. Efikasiteti dhe efektiviteti në procesin e ndërtimeve të larta në Komunën e Ferizajt;
6. Mirëmbajtja e autostradave;
7. Zbatimi i kriterit “Tenderi Ekonomikisht më i Favorshëm” në prokurimin publik;
8. Sistemi i Integruar Informativ për Skemat Pensionale; dhe
9. Sistemi i regjistrimit të bizneseve.

Të nderuar përfaqësues të mediave,

Fillimisht, dua t'ju informoj lidhur me auditimin e performancës “Monitorimi, mirëmbajtja dhe siguria e digave në Kosovë”.

Sot kemi finalizuar raportin auditimit “Monitorimi, mirëmbajtja dhe siguria e digave në Kosovë. Ky raport i auditimit nuk do të publikohet, por vetëm i është dërguar palëve audituese përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-063 për Informacionin e Klasifikuar dhe Verifikimin e Sigurisë dhe Ligjin nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe duke marr për baze edhe rekomandimin nga organet kompetente për siguri, kam marrë vendim që raporti i auditimit “Monitorimi, mirëmbajtja dhe siguria e digave në Kosovë” të klasifikohet me nivelin “I Kufizuar”. Kjo për faktin se të dhënat e paraqitura në raport nuk janë të përshtatshme të jenë të qasshme për publikun e gjerë, pasi mund të cenojnë sigurinë e infrastrukturës vitale dhe asetëve të tjera me rëndësi të veçantë, si dhe të ekspozojnë dobësi që mund të rrisin rreziqet për sigurinë publike dhe funksionimin e sigurt të kësaj infrastrukture kritike.

Dua t'ju siguroj juve mediave dhe qytetareve se nuk qëndron asnjë arsye tjetër prapa këtij vendimi. Para se të marr këtë vendim kemi ndjekur të gjitha hapat procedurale dhe ligjore për tu siguruar se jemi në pajtim me kornizën ligjore dhe prapa këtij vendimi qëndron vetëm mbrojtja e interesit publik. Shfrytëzoj rastin ta falënderoj Agjencinë Kosovare për Inteligjencë dhe Agjencinë për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar për mbështetjen në këtë proces.

Siguria e digave përbën një aspekt thelbësor të menaxhimit të burimeve ujore dhe mbrojtjes së infrastrukturës kritike në Kosovë. Digat janë objekte strategjike që shërbejnë për furnizim me ujë të pijshëm, ujitje, energji elektrike dhe kontroll të përmytjeve.

Objektivë e këtij auditimi ishte vlerësimi i mënyrës se si institucionet përgjegjëse garantojnë mirëmbajtjen periodike dhe monitorimin efektiv të digave për të siguruar funksionimin e tyre të sigurt. Auditimi është fokusuar në periudhën 2021–2024, mirëpo për çështje krahasimore, kemi analizuar periudhën nga themelimi i Autoritetit Rajonal i Pellgjeve Lumore në 2004 e deri në vitin 2025 ku edhe po zhvillohet projekti për studime dhe investime në digat kryesore. Auditimi ka përfshirë tri digat kryesore me rëndësi strategjike: Ujmanin, Batllavën dhe Badovcin. Në auditim janë

përfshirë Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore ne kuadër të Ministrisë se Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ndërmarrja Publike “Ibër-Lepenc”, që menaxhon digën e Ujmanit; Kompania Rajonale e Ujësjesit “Prishtina”, dhe Korporata Energjetike e Kosovës si pronar i digës së Batllavës.

Ky auditim është realizuar si auditim paralel me Kontrollin e Lartë të Shtetit të Republikës së Shqipërisë (KLSH), në kuadër të bashkëpunimit profesional ndërmjet institucioneve supreme të auditimit. Njëpërmjet këtij bashkëpunimi është mundësuar shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira në fushën e monitorimit dhe menaxhimit të sigurisë së digave, si dhe krahasimi i qasjeve institucionale në dy vendet.

Procesi i auditimit është mbështetur gjithashtu nga ekspertët e fushës të KLSH, të cilët kanë kontribuar në forcimin e aspektit metodologjik dhe në harmonizimin me standardet dhe praktikat ndërkombëtare për sigurinë e infrastrukturës ujore.

Me këtë rast, shfrytëzojë rastin të shpreh mirënjohjen time dhe falënderimin ndaj Kontrollit të Lartë të Shtetit të Republikës së Shqipërisë dhe ekspertëve të angazhuar në këtë proces, për bashkëpunimin profesional, mbështetjen teknike dhe kontributin e çmuar në realizimin e këtij auditimi.

Për të adresuar mangësitë e identifikuar, Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë gjithsej 24 rekomandime, të drejtuara ndaj institucioneve përgjegjëse në nivel qendror dhe operatorëve të digave.

Të nderuar Media,

Shpalosjen e rezultateve kryesore të tri auditimeve të performancës që publikohen sot do të vazhdoj Zëvendës Auditori i Përgjithshëm z. Beza Halilaj.

Përshëndetje të nderuar media,

Plani i auditimit të ZKA-së, ka përfshirë ndër të tjera edhe auditime të performancës për tri prej të cilave do sjellë para jush informacionet kryesore.

Një auditim i tillë është kryer në Ndërmarrjen Publike Termokos, duke vlerësuar: **“Efektiviteti i shërbimit të ngrohjes qendrore Termokos”**

Ky auditim, ka rrjedhë si rezultat i shqetësimeve dhe ankesave publike të qytetarëve në lidhje me shërbimin e ngrohjes. Qëllimi i këtij auditimit ishte që të vlerësohet se

sa “Termokos” ka qenë efektiv në shpërndarjen e energjisë termike, sa ka zhvilluar faturim të drejtë dhe furnizim të qëndrueshëm.

Rezultatet tona të auditimit tregojnë se Termokos përballet me sfida të konsiderueshme në menaxhimin e sistemit të ngrohjes qendrore, të cilat lidhen me mangësi në menaxhimin teknik të rrjetit, me dobësi në sistemin e matjes dhe faturimit, si dhe mungesë të sigurisë rezervë për furnizim.

Analizat tona tregojnë se “Termokos” nuk ofron shërbim efektiv të ngrohjes qendrore për qytetarët e Prishtinës. Shpërndarja e energjisë termike është e pa balancuar dhe si pasojë, disa lagje si Dardania dhe Ulpiana kanë mbingrohje, ndërsa në lagjet si Kodra e Diellit dhe Mati 1 nuk arrijnë të marrin ngrohje të mjaftueshme. Edhe pse Termokos me Rregullore përkatëse e ka obligim të zbatoj modelin e “diagramit rrëshqitës” për rregullimin e temperaturës së furnizimit sipas temperaturës së ambientit të jashtëm, nuk e zbaton një gjë të tillë, por operon kryesisht bazuar në parametrat reale të ngarkesës së rrjetit. Si pasojë, furnizimi me energji termike nuk përshtatet me kushtet klimatike, gjë që shkakton përdorim joefikas të energjisë.

Gjatë analizës së të dhënave nga sistemi, kemi konstatuar se disa termometra të vendosur në nënstacione, të cilët matin temperaturën e ambientit të jashtëm, nuk raportojnë gjendje të saktë. Në disa raste temperatura ka rezultuar të jetë deri në 84.83°C. Termometrat luajnë rol të rëndësishëm pasi që shërbejnë si bazë për përcaktimin e temperaturës së furnizimit me energji termike.

Nga 869 nënstacione aktive që ka Termokos, prej tyre 285 nënstacione nuk janë të integruara në sistem, çka nënkupton se temperatura e furnizimit nuk kontrollohet sipas një limiti të përcaktuar. Për më tepër, 59 nënstacione të tjera, përveç mungesës së integritetit në sistem, nuk janë të pajisura me sistem rregullimi funksional dhe vazhdojnë të operojnë pa kontroll adekuat të temperaturës dhe rrjedhës, duke kontribuar në shpërndarje jo të njëtrajtshme të energjisë termike. Kjo ndikon drejtpërdrejt në pamundësinë për të siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe të barabartë për të gjithë konsumatorët.

Termokos nuk e zbaton metodologjinë e miratuar, por përdor metodologji të pa aprovuar. Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në vitin 2022 ka plotësuar dhe ndryshuar metodologjinë e faturimit për ngrohjen qendrore. Megjithatë, Termokos ka vazhduar të përdorë një metodologji tjetër të pa aprovuar e cila lejon forma të ndryshme të faturimit duke përfshirë konsumator me matje dhe ata me m² në një objekt të njëjtë

banesor gjë që krijon padrejtësi ndërmjet konsumatorëve. Konsumatorët me matje individuale mund të kursejnë energji dhe të ulin konsumin e tyre, por vazhdojnë të faturohen edhe për një pjesë të konsumit të përbashkët të shpërndarë sipas sipërfaqes. Ndërkohë, konsumatorët pa matje individuale faturohen sipas m² dhe nuk kanë mjet stimulues për kursim.

Nga analizimi i faturimit në Termokos, është konstatuar se për të njëjtën periudhë faturimi, një konsumator me matës individual dhe sipërfaqe 111 m² është faturuar 179.49€, ndërsa një konsumator pa matës individual me sipërfaqe të njëjtë (111 m²) është faturuar 117.13 €.

Nga kjo vërehet se, përdorimi i një metodologjie të pa miratuar (dokument jo valid), paraqet rrezik në zbatimin e saj dhe ndikon në trajtim jo të barabartë të konsumatorëve dhe në shpërndarje jo të drejtë të kostos së energjisë termike.

Rreth 46.5% e konsumatorëve ende faturohen sipas m², gjë që nuk pasqyron konsumin real midis atyre me matje individuale dhe atyre pa matës. Termokos ende nuk kanë ndonjë datë të caktuar se kur duhet të përfundoj implementimi me pajisje matëse për të gjithë konsumatorët.

Për më tepër, 5.61% e konsumatorëve kanë të vendosur matës, por janë jashtë funksionit dhe vazhdojnë të faturohen sipas sipërfaqes. Një nga arsyet kryesore për mos zëvendësimin e pajisjeve matëse është se mbi 90% e pajisjeve tashmë e kanë kaluar afatin e garancionit dhe çdo prishje e tyre nënkupton që ata konsumator në mënyrë automatike kthehen në faturim me m².

Në anën tjetër, kemi konstatuar se mbi 16,700 m² sipërfaqe të pa faturuara për shumë vite që shfrytëzojnë ngrohjen. Kjo për shkak se, Termokos nuk ka kryer verifikim të sipërfaqeve ngrohëse për më shumë se një dekadë. Rreth 1,245 konsumatorë kanë paguar më pak për ngrohjen qendrore për shkak të zvogëlimit të sipërfaqes së ngrohjes gjatë periudhave të më hershme. Analiza e të dhënave tregon se në disa raste diferenca arrin në mbi 80 m² për një njësi banimi, ndërsa në raste të tjera diferencat janë rreth 30–50 m². Si pasojë e mos përditësimit sistematik dhe mos verifikimit të evidencave të vjetra të sipërfaqeve konsumatorët për një periudhë të gjatë janë faturuar mbi baza të pasakta të sipërfaqes ngrohëse.

Po ashtu, gjatë verifikimit të mostrave për regjistrimin e konsumatorëve të rinj, kemi konstatuar se në shumicën e rasteve sipërfaqja e ngrohjes merret nga lista të

përpiluara nga investitori, të cilat përmbajnë të dhënat e konsumatorëve të ndërtesës, por nuk shoqërohen me planin zyrtar të saj.

Kemi vërejtur se Termokos nuk ka kapacitete rezervë për prodhimin e energjisë termike, pasi që kaldajat ekzistuese me mazut janë jashtë funksionit dhe furnizimi me ngrohje qendrore varet plotësisht nga prodhimi i energjisë nga KEK. Deri më tani, në projektet e planifikuara nuk është paraparë investimi për krijimin e rezervave të veta për modernizimin e kaldajave. Nëse KEK-u për arsye të ndryshme dështon të furnizoj me ngrohje qendrore për qytetarët apo ofron cilësi të dobët, nga kjo ndikohen kryesisht lagjet që kanë furnizim të pamjaftueshëm të energjisë gjatë tërë sezonës. Për të adresuar çështjet e identifikuar në këtë auditim, Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë gjithsej 9 rekomandime.

Auditimi i performancës: Efikasiteti dhe efektiviteti i administrimit të pronave nga Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP)

Auditimi është kryer për të vlerësuar nëse Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP) ka vendosur mekanizma efektivë që sigurojnë administrim të ligjshëm, efikas dhe transparent të pronave nën administrimin e saj.

Rezultatet tona të auditimit tregojnë se Agjencia nuk ka siguruar administrim mjaftueshëm efikas dhe efektiv të pronave nën administrim, megjithatë disa çështje për përmirësim janë identifikuar dhe adresuar përmes këtij auditimi.

Sistemi elektronik i administrimit të pronave nuk është funksionalizuar plotësisht, pasi që vetëm moduli i administrimit të pronave është në përdorim, ndërsa modulet e të hyrave dhe financave nuk janë funksionale që nga viti 2018. Si rrjedhojë, të dhënat për të hyrat dhe aspektet financiare administrohen në mënyrë manuale, pa integrim me regjistrin kryesor dhe pa raporte automatike që do të mundësonin mbikëqyrje të konsoliduar. Po ashtu, regjistri i pronave nuk përmban të dhëna të plota dhe të standardizuara për shfrytëzuesit e afër dhjetë mijë pronave.

Ka mungesë të integritetit dhe gjurmueshmërisë përkatësisht dokumentimit të të dhënave. Zyrat rajonale mbajnë të dhëna paralele në Excel për shkak se sistemi nuk mundëson regjistrimin e shënimeve të detajuara. Këto të dhëna nuk janë të standardizuara dhe nuk janë të integruara në regjistrin qendror, duke fragmentuar informacionin. Po ashtu, raportet e inspektimeve ruhen kryesisht në formë fizike në zyrat rajonale dhe nuk ngarkohen në sistemin elektronik, gjë që nuk i mundëson nivelit qendror qasja te drejtpërdrejtë për verifikim të përmbajtjes dhe rezultateve.

Po ashtu, kemi konstatuar dobësi në planifikimin, realizimin dhe dokumentimin e inspektimeve. Megjithëse parashihet me kornizë ligjore që çdo pronë të inspektohet dy herë në vit, nuk ekziston plan vjetor i detajuar i inspektimeve që përcakton listën e pronave, afatet, dhe përgjegjësit. Për pasojë janë konstatuar vonesa të konsiderueshme në kryerjen e inspektimeve në 3,626 raste, me vonesa që shtrihen nga disa, deri në mbi pesë mijë ditë, duke e reduktuar efektin parandalues dhe korrigjues të inspektimit.

Këto mangësi në procesin e inspektimit kanë ndikuar edhe në trajtimin joefektiv të rasteve të shfrytëzimit të paautorizuar të pronave. Në këtë drejtim, kemi konstatuar se Agjencia nuk ka siguruar trajtim të duhur të rasteve me shfrytëzues të panjohur dhe të paautorizuar. Kur shfrytëzuesi është i panjohur, vendosen njoftime në pronë, por këto njoftime nuk përmbajnë elemente detyruese, afate të qarta dhe paralajmërim për masa administrative apo hapa të mëtejme. Mungesa e standardizimit të përmbajtjes së njoftimeve dhe e procedurave pasuese e redukton efektin parandalues të ndërhyrjes dhe krijon rrezik që shfrytëzimi i paautorizuar të vazhdojë pa u trajtuar në mënyrë efektive.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë 10 rekomandime që synojnë adresimin e mangësive të identifikuara në sistemin e administrimit dhe mbikëqyrjes së pronave.

Auditimi i performancës i teknologjisë së informacionit: Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve

Përmes këtij auditimi është vlerësuar nëse Universiteti i Prishtinës, ka menaxhuar dhe administruar platformën elektronike për Menaxhimin e Studentëve (SEMS) në mënyrën e duhur dhe nëse platforma siguron mbështetje efektive dhe të sigurt për funksionet kryesor (akademike dhe administrative) të organizatës.

Në kuadër të këtij auditimi, është konstatuar se, megjithëse janë arritur përparime në digjitalizimin e shërbimeve, ekzistojnë ende mangësi të rëndësishme në qeverisjen e teknologjisë së informacionit, kontraktimin, kontrollet e aplikacionit dhe planifikimin për vazhdimësinë e biznesit.

Gjetjet tregojnë se Universiteti nuk ka politika të formalizuara për qeverisjen e TI-së, menaxhimin dhe monitorimin e rreziqeve, vazhdimësinë e biznesit dhe dokumentimin e proceseve. Gjithashtu, kërkesat për zhvillime dhe ndryshime në sistem trajtohen kryesisht në mënyrë joformale dhe pa prioritizim të qartë.

Auditimi konstatoi varësi të konsiderueshme nga operatori ekonomik që zhvillon dhe mirëmban sistemin SEMS. Po ashtu, kontratat nuk përmbajnë elemente të mjaftueshme për monitorimin e performancës, sigurinë e të dhënave dhe menaxhimin e incidenteve. Ndërsa, janë evidentuar edhe raste të ofrimit të shërbimeve pa mbulim kontraktual.

Në aspektin e funksionimit të sistemit, janë identifikuar mangësi në kontrollet e aplikacionit, përfshirë menaxhimin e privilegjeve të përdoruesve, mungesën e kontrolleve për mbivendosjen e orareve të profesorëve, përdorimin jo të plotë të sistemit nga Fakulteti i Mjekësisë dhe mosdigjitalizimin e plotë të pagesave të studentëve.

Gjithashtu, SEMS nuk ka plan të rikuperimit nga fatkeqësitë, ambient testues dhe qendër alternative për rimëkëmbje, çka rrit rrezikun e ndërprerjeve të shërbimeve dhe humbjes së të dhënave. Në tërësi, këto mangësi ndikojnë në sigurinë, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e funksionimit të sistemit.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë 16 rekomandime, të cilat synojnë forcimin e qeverisjes së TI-së, kontraktimin, kontrollet e aplikacioneve si dhe për planin e vazhdimësisë së biznesit për platformën SEMS në Universitetin e Prishtinës.

Bashkëpunimi i ZKA-së me prokurorin e shtetit

Ju informoj se Njësia Kundër Mashtrimit në kuadër të Departamenti Juridik është në proces të analizimit të gjetjeve dhe rasteve të identifikuar në raportet e auditimit të publikuara për vitin 2025, me qëllim të vlerësimit të tyre për trajtim të mëtejshëm në Prokurorinë e Shtetit. Për rrjedhojë, deri në këtë fazë të procesit, ende nuk kemi referuar raste në Prokurorinë e Shtetit që ndërlidhen me raportet e auditimit të publikuara për vitin 2025. Për rastet e identifikuar dhe adresuara në Prokurorinë e Shtetit, do të njoftoheni në komunikime tjera të ardhshme.

Konkluzion përfundimtar nga AP

Në përmbyllje, dëshiroj të theksoj se, organizatat buxhetore, rekomandimet e marruar duhet ti pranojnë si një kontribut serioz me qëllim kryesor përmirësimin e proceseve, aktiviteteve dhe operacioneve të organizatave të tyre. Kjo padyshim se do të ndikojë në përmirësimin e përgjithshëm të menaxhimit më të mirë të parasë publike dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara.

Zyra Kombëtare të Auditimit, në përputhje me mandatin e përcaktuar kushtetues dhe ligjor do të jetë e gatshëm të ndihmojmë në adresimin sa më efikas të rekomandimeve të dhëna në të mirë të interesit publik.

Ju falënderoj për prezencën tuaj dhe bashkëpunimin e deritanishëm me ju!